



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.313, datë 30.11. 2022

PËR

“MIRATIMIN E PROGRAMIT QË PËRCAKTON LISTËN E PROKURORËVE, PËR TË CILËT DO TË KRYHET VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL INDIVIDUAL PËRGJATË VITIT 2023”

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a” të Kushtetutës, në nenet 159, pika 2, germa “a” dhe “e”, 164, pika 8, 184, germa “dh”, 189, pika 1, germa “c”, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe në nenet 68, 84, 85 dhe 97, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në Rregulloren “Për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e paraqitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë programin që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional individual përgjatë vitit 2023, sipas aneksit Nr.1 bashkëlidhur relacionit.
2. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore dhe Prokurorët e komanduar pranë Këshillit pjesë e kësaj njësie, për ndjekjen e këtij procesi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 30.11.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Seiti



ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Ledina Riza